

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Zabeli-Kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, antarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.B., nga fshati ..., Komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par. 1 nën par. 1.5 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të dëmtuarit R.I., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P.nr.5/2016, datë 21.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 30.03.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të dëmtuarit R.I., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P.nr.5/2016, datë 21.02.2018, **Vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.5/2016, datë 21.02.2018, të akuzuarin L.B. e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par. 1 nën par. 1.5 të KPK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ekzekutimi i të cilit është shtyrë në afat prej 2 (dy) vite, me kusht që i akuzuari brenda kësaj periudhe nuk do të kryej vepër tjetër penale. Është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 30 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 10 €. I dëmtuari R.I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i dëmtuar R.I., dhe atë vetëm për shkak të vendimit për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim me burg efektiv apo të njëjtin aktgjykim ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Brenda afatit ligjor, përgjigje në ankesën e të dëmtuarit ka paraqitur edhe i akuzuari L.B., me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të dëmtuarit ta refuzoj si të pabazuar, kurse aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.353/2018, datë 16.04.2018, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarit të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg efektiv, kurse përgjigja në ankesë e ushtruar nga i akuzuari, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigje në ankesë, gjeti se:

## **Ankesa nuk është e bazuar.**

Duke e shqyrtuar ankesën e të dëmtuarit, kolegji penal i Gjykatës së Apelit gjen se nga brendia e ankesës, i dëmtuari përveç vendimit për dënim, i referohet edhe bazës ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mirëpo kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se ankesa e të dëmtuarit në këtë drejtim sa i përket kësaj baze ankimore, nuk është e lejuar konform nenit 381 par. 2 të KPP-së, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale, për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vepra penale për të cilën i akuzuari L.B. është shpallë fajtor, (lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par. 1 nën par. 1.5 të KPK-së), hynë në kategorinë e veprave penale, ku lejohet ankesa e të dëmtuarit, mirëpo ankesa në këtë drejtim mund të bëhet vetëm për shkak vendimit lidhur me sanksionin penal, por jo edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Andaj, konform nenit 400 të KPP-së kjo gjykatë, ankesën e të dëmtuarit R.I. nuk e shqyrtoj në këtë drejtim, ngase e njëjta është e palejuar, sepse të dëmtuarit në rastet kur ankesa është e lejuar ka të drejte në ankesë vetëm për vendimin e gjykatës sa i përket sanksionit penal, e jo edhe për bazat tjera ankimore ashtu siç ka vepruar e dëmtuara në rastin konkret.

Mirëpo, kolegji penal i Gjykatës së Apelit, edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Meqë me ankesë nuk është kontestuar gjendja faktike, ajo nuk qe objekt vlerësimi i kësaj gjykate, prandaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, me ankesë i dëmtuari pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është shumë i butë, gjykata në rastin konkret nuk ka marrë për bazë qëllimin e dënimit, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, ngase sipas të dëmtuarit sjellja e të akuzuarit do të duhej të merret si rrethanë rëndues për faktin se i njëjti njihet edhe si person i dyshuar për shumë vepra penale, gjë që vërtetohet në bazë të të dhënave në polici, po ashtu i njëjti asnjëherë nuk e ka pranuar këtë vepër penale, nuk ka kërkuar falje dhe gjithmonë ka pasur dhe ka sjellje çnjerëzore me të dëmtuarin. Andaj, në bazë të kësaj pretendon se dënimi i shqiptuar me kusht të akuzuarit nuk është në proporcion me veprën penale dhe me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe me këtë nuk është arritur qëllimi i dënimit, e as të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. Më tej shton se kjo vepër penale është kryer me dashje dhe atë me dashje direkte, i njëjti vazhdimisht ka pasur sjellje çnjerëzore duke e ofenduar dhe duke e kërcënuar të dëmtuarin, prandaj edhe i ka propozuar Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të dëmtuarit për shqiptimin e një dënimi me burgim efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat konform dispozitës së nenit 64 të KPK-së ( i aplikueshëm në rastin konkret), të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë për bazë faktin se i njëjti është i martuar dhe mbajtës i familjes, sjelljen e tij korrekte para gjykatës, faktin se nga momenti i

kryerjes së veprës penale e deri në momentin e marrjes së vendimit në këtë çështje penale kanë kaluar afërsisht gjashtë vite, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë mënyrën e kryerjes së kësaj veprë penale dhe në prani të këtyre rrethanave të njëjtit i a shqiptuar dënimin si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit, si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se në praninë e rrethanave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të ashpër apo me burg efektiv, ashtu siç pa të drejtë pretendon i dëmtuari në ankesë. Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e të dëmtuarit, nuk qëndrojnë, ngase të njëjtat sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim me burg efektiv, prandaj duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, faktin se i akuzuari është i martuar dhe mbajtës i familjes, si dhe duke marrë për bazë edhe faktin se që nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, pastaj duke marrë për bazë edhe mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, e meqë në ankesë nuk është theksuar ndonjë rrethanë veçanërisht e re rënduese dhe e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, e që deri diku do ta justifikonte një dënim të tillë siç pretendohet në ankesën e të dëmtuarit, kjo gjykatë konsideron se dënimi i shqiptuar me burgim e i kushtëzuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se me një dënim të tillë do të ndikohet që të parandaloj të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe do të ndikoj në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, që është edhe qëllim i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.344/2018, datë 30.04.2018

Zyrtari ligjor  
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit  
Gani Zabeli

#### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Shqipe Qerimi